

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/ Ekzekutimi i 44-vjeçarit, Hita mbërrin me urgjencë në Sarandë. Takim me strukturat vendore të p olicisë
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/video-ekzekutimi-i-44-vjecarit-hita-mberrin-me-urgjence-ne-sarande-ta-i46863
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 15:33:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 15:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9a8d8a6c411968f79147f03e1b220e835998f57cb80055480ea21e6db89885f7
TEKSTI	17323b11dc227da9b072c2ecb3164bc2b36da40a3576ffc38398a56269ac85c9
PAMJA	0325ee3b225143a7ad9151dec332a58a1e21bfa224eb29120f4fb2dcf80bcf2b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2491b5d87c4ed8ab52e480a3b7e2579024b3f2f9787aee4bd171fe0ad7d450d9
E MËPARSHMJA	51f1424a42b632e27f3662011df25238b49d1bd48096ee2c0188db3d06044c70
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/2491b5d87c4ed8ab52e480a3b7e2579024b3f2f9787aee4bd171fe0ad7d450d9

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

Ekzekutohet “Tani i Rruzhdit” në zemër të Sarandës, autorët me motor dhe skafandra e qëlluan sapo doli nga lokali! Hita takim urgjent me strukturat e policisë

20 Shtator 2026, 10:23

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

—

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 20 Shtator 2026, 17:12

VIDEO/ Ekzekutimi i 44-vjeçarit, Hita mbërrin me urgjencë në Sarandë. Takim me strukturat vendore të policisë

Policia ka ngritur pika kontrolli në aksin drejt Vlorës dhe Gjirokastrës, në përpjekje për të identifikuar dhe kapur autorët.





Pas vrasjes së 44-vjeçarit Artan Murta, i ekzekutuar me armë zjarri paraditen e kësaj të diele në Sarandë, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skënder Hita, ka mbërritur në qytetin bregdetar, ku ka zhvilluar takime me drejtuesit vendorë të Policisë.

Gjatë takimit, Hita ka kërkuar një hetim të shpejtë dhe të thelluar për ngjarjen, si dhe një skanim të plotë të situatës kriminale në Sarandë. Sipas tij, duhet të evidentohen konfliktet më të mprehta, por edhe ato në dukje më të vogla, personat me precedentë penalë dhe kontingjenti kriminal që vepron në zonë, përfshirë edhe persona që vijnë nga qytete të tjera.

“Goditja pa kompromis e grupeve kriminale që veprojnë në qytet dhe evidentimi i çdo veprimtarie të paligjshme të tyre. Do t’ju mbështes me burime njerëzore, duke krijuar struktura të specializuara për hetimin e krimeve të rënda dhe kundër kimit të organizuar, por edhe me bazë logjistike. E rëndësishme është reagimi profesional dhe përkushtimi i strukturave aktuale”, deklaroi Hita.

Në kuadër të operacionit për zbardhjen e vrasjes, kontrollet po kryhen edhe me dronë në zona të ndryshme të Sarandës dhe Delvinës. Ndërkohë, grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon administrimin dhe analizimin e provave që mund të çojnë në identifikimin e autorëve.

Pas ngjarjes, policia ka ngritur gjithashtu pika kontrolli në drejtim të Vlorës dhe Gjirokastrës, ndërsa vijon kërkimi për personat e dyshuar.

Nga të shtënat që i morën jetën 44-vjeçarit Murta, mbeti i plagosur edhe një kalimtar i rastësishëm. 73-vjeçari Xhevdet Skëndaj u qëllua në shpinë teksa po kalonte rrugën dhe u transportua në spital për ndihmë mjekësore.

Sipas të dhënave paraprake, autorët dyshohet se kanë qenë dy persona, të cilët kanë lëvizur me motor dhe kanë mbajtur skafandra, ndërsa më pas janë larguar nga vendngjarja.

Takimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë me strukturat vendore vjen pas një serie ngjarjesh të rënda kriminale të regjistruara muajt e fundit në qytetin bregdetar.

Hetimet vijnë për zbardhjen e plotë të rrethanave të vrasjes, identifikimin e autorëve dhe përcaktimin e motivit të krimit./Versus.al

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Skender Hita, zhvilloi analizë me strukturat e Komisaritit të Policisë Sarandë, pas ngjarjes së rëndë të ndodhur paraditen e sotme, ku mbeti i vrarë me armë zjarri një 44-vjeçar dhe u plagos një 73-vjeçar, kalimtar i rastit.

Gjatë analizës, Drejtori i Përgjithshëm kërkoi hetime të shpejta dhe të thelluara, si dhe një skanim tërësor të situatës operative, nga evidentimi i konflikteve më të mprehta deri te konflikt... Shiko më shumë

👍 142 💬 15 ➡ 3

Poll



AKTUALITET

[“Jo në emrin tim”, shqiptarët protestojnë në Vjenë kundër vendimit të Hagës](#)

20 Shtator 2026, 17:40

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Aksident në aksin Peshkopi-Maqellarë, plagosen nënë e bir nga Kukësi. Nisen me urgjencë drejt Tiranës](#)

20 Shtator 2026, 17:31

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Zjarr në Babicë të Vlorës, flakët rrezikojnë një banesë](#)

20 Shtator 2026, 17:07

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Hyri për të grabitur pronën, shqiptari q*llohet për vd*kje nga pronari italian](#)

20 Shtator 2026, 16:14

^ekstrakti^





AKTUALITET

[Skandal/ Publikohet videoja kur zyrtari serb përdorte fjalor banal gjatë gjyqit në Hagë!](#)

20 Shtator 2026, 14:53

[^ekstrakti^](#)



AKTUALITET

[Kënga për Enver Hoxhën në Bibliotekën e Lushnjës, institucioni sqaron videon: Gruaja vjen nga një familje e persekutuar dhe po rrëfente fëmijërinë](#)

20 Shtator 2026, 14:44

[^ekstrakti^](#)



AKTUALITET

[Vr*sja e Lumturie Patushit, nipi 14-vjeçar tregon minutat e fundit të gjyshes](#)

20 Shtator 2026, 14:05

[^ekstrakti^](#)



AKTUALITET

[Punësohej dhe vidhte xhirot ditore, arrestohet ekspertja e punësimit Kumrie Zika](#)

20 Shtator 2026, 13:45

[^ekstrakti^](#)

[^ekstrakti^](#)

[Te tundeni](#)



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.